




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.17 dhe 1.24 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nent 75, 76, 77, dhe 78 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave si dhe nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 korrik 2023,

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2023

**PËR INSTALIMIN DHE PËRDORIMIN E KAMERAVE TË SIGURIMIT
DHE RUAJTJEN E VIDEO REGJISTRIMEVE NË GJYKATAT E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim krijimin e rregullave dhe procedurave standarde, për instalimin dhe përdorimin e kamerave të sigurimit, si dhe ruajtjen e video regjistrimeve në gjykatat e Republikës së Kosovës, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë për objektet e gjykatave, punonjësve dhe publikut, duke vepruar si masë shtesë.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky udhëzim administrativ zbatohet për të gjithë punonjësit përgjegjës të cilët janë të autorizuar për përdorimin e kamerave të sigurimit, si dhe ruajtjen e video regjistrimeve në gjykatat e Republikës së Kosovës, me qëllim që të sigurohet integriteti personal i punonjësve të gjykatës dhe qytetarëve që ndodhen në objektet e gjykatave.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin:

- 1.1. **Këshilli** - Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.2. **Sekretariati i Këshillit** – Njësi organizative brenda Këshillit, siç parashihet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.3. **Zyrtari përgjegjës i Sekretariati të Këshillit** - koordinatorin e sigurimit i cili është përgjegjës për udhëheqjen dhe koordinimin e punëve dhe shërbimeve që lidhen me sigurimin në Këshill dhe të gjitha gjykatat;
- 1.4. **Vend publik** - objekti i gjykatës, ku personat kanë të drejtë të hyjnë dhe të qëndrojnë, përfshirë hapësirat e brendshme të gjykatave, si zonat e pritjes, korridoret, sallat e gjykimit, dhe çdo tjetër hapësirë në objektin e gjykatës që është e qasshme për të gjithë personat për qëllime të ligjshme;
- 1.5. **Hapësire publike** - çdo vend në të cilin ka çasje publiku ose ndonjë pjesë e publikut me pagesë ose në mënyrë të ndryshme, si e drejtë ose në bazë të lejes së shprehur ose të nënkuptuar;
- 1.6. **Subjekt i të dhënave** - çdo person fizik të cilit i janë mbledhur apo i janë përpunuar të dhënat personale;
- 1.7. **Transmetimi** - bartja e të dhënave personale të mbledhura/ruajtura të marrësit/kërkuesit, sipas kërkesës së parashtruar;
- 1.8. **Përpunimi i të dhënave** - çdo veprim i cili kryhet në të dhënat e mbledhura, si: regjistrimi, grumbullimi, ruajtja, klasifikimi, kategorizimi, sistemimi, publikimi, shpërndarja, bllokimi, transferimi, ndryshimi dhe asgjësimi i këtyre të dhënave;
- 1.9. **Shkelje e të dhënave personale** - nënkupton çdo shkelje të masave të sigurisë që sjell asgjësimin, humbjen, ndryshimin, deklarimin apo qasjen e paautorizuar në të dhënat personale, si dhe përpunimin e këtyre të dhënave në kundërshtim me ligjin dhe aktet tjera nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 4 Vendosja e kamerave dhe përdorimi

1. Sistemi i vëzhgimit me kamerë instalohet në ato vende në të cilat paraprakisht është marrë vendim nga Sekretariati i Këshilli në bashkërendim me kryetarët dhe administratorët e gjykatave.

2. Kamerat e sigurimit vendosen në hapësirat publike brenda dhe jashtë gjykatës dhe më saktësisht do të mbulojnë:

- 2.1. pjesën publike hyrëse;
 - 2.2. korridoret;
 - 2.3. sallat e gjykimit (hyrjen në sallën e gjykimit ose hyrjen në hapësirat tjera që shfrytëzohen për zhvillimin e seancave gjyqësore);
 - 2.4. perimetrin e jashtëm (oborri) të objektit të gjykatës.
3. Kamerat e sigurimit nuk do të vendosen në dhe afër hapësirave që janë në funksion të dëshmitarëve të mbrojtur.
4. Në ato ndërtesa ku mund të jenë të vendosura dy (2) apo më shumë gjykata, do të instalohet vetëm një sistem i vëzhgimit me kamerë.
5. Kamerat e sigurimit, këndi i të cilave mbulon në mënyrë të përhershme atë pjesë, nuk do të vendosen në apo afër hapësirave tjera që mund të cënojnë integritetin personal të punonjësve dhe palëve si: në tualet, hapësira të mbyllura të punës, zyra, ashensorë si dhe në hapësira që në parim publiku nuk ka apo nuk mund të ketë qasje të drejtpërdrejtë pa leje paraprake të zyrtarëve të gjykatës, zyra apo këndin e destinuar për përfaqësues të palëve ndërgjyqësore.
6. Kamerat vendosen në atë mënyrë që këndi i mbulimit të jetë sa më i gjerë, duke respektuar perimetrin e gjykatës me qëllim që të eliminoj maksimalisht “pikat e vdekura”.
7. Vetëm zyrtari përgjegjës nga Sekretariati i Këshillit, kryetari dhe administratori përkatës i gjykatës, do të jenë në dijeni për instalimin dhe vendosjen e kamerave imituese (false).
8. Të gjitha objektet gjyqësore, në të cilat instalohet sistemi i kamerave të sigurimit do të vendosen njoftimet/shenjat paralajmëruese të cilat duhet të përmbajnë informacione se objekti është nën vëzhgimin me kamerë si dhe të dhënat e gjykatës, adresën kontaktuese, afatin e ruajtjes dhe qëllimin e vendosjes. Të njëjtat do të vendosen në objektet e gjykatave, në pjesën hyrëse, dhe së paku nga një njoftim në çdo kat të gjykatës.

Neni 5

Kategoria e subjekteve të të dhënave personale

1. Kategoria e subjekteve të të dhënave personale që iu përpunohen të dhënat personale janë:
 - 1.1. të punësuarit në gjykata;
 - 1.2. palët; dhe,
 - 1.3. vizitorët e tjerë që hyjnë dhe dalin nga objektet e gjykatave.

Neni 6

Personi përgjegjës për funksionimin e sistemit të kamerave të sigurimit

1. Administratori i gjykatës është përgjegjës për funksionimin, mirëmbajtjen, mbledhjen dhe ruajtjen e video regjistrimeve të bëra nga kamerat e sigurimit dhe ka të drejtat e administratorit të këtij sistemi.
2. Në ato ndërtesa ku mund të jenë të vendosura dy apo më shumë gjykata, Sekretariati i Këshillit cakton me shkrim një nga administratorët e njëjës gjykatë si personin përgjegjës për atë sistem të vëzhgimit me kamerë.
3. Administratori mund të delegojë këto përgjegjësi me shkrim tek zyrtari përkatës, me ç'rast duhet të njoftojë me shkrim kryetarin e gjykatës dhe zyrtarin përgjegjës në Sekretariatit të Këshillit, për delegim të kompetencës.
4. Zyrtari përgjegjës në gjykatë/zyrtari i sigurimit apo receptionisti që operon me sistemin e kamerave të sigurimit, ka të drejtë vetëm në shikim dhe monitorim të sistemit të vëzhgimit me kamerë, por jo edhe të drejtën e ruajtjes apo nxjerrjes së regjistrimeve.
5. Të gjithë zyrtarët përgjegjës, për mbikëqyrjen e sistemit të kamerave, do të vijojnë trajnimin rreth punës me sistemin e kamerave si dhe do të njoftohen mbi përgjegjësitë që dalin nga ky udhëzim.
6. Të drejtë qasjeje në dhomën e monitorimit ka kryetari i gjykatës, administratori i gjykatës, zyrtari përgjegjës i Sekretariatit të Këshillit, stafi i sigurimit dhe receptionisti.

Neni 7

Konfidencialiteti

1. Punonjësi përgjegjës, i cili merret me instalimin e sistemit të vëzhgimit, përpunimin e të dhënave personale dhe personeli, të cilët kanë të drejtën e qasjes në këto të dhëna, përfshirë edhe stafin e kompanisë së kontraktuar për instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të vëzhgimit, nëse ka të tillë, duhet që ta kenë nivelin adekuat të verifikimit të sigurisë.
2. Punonjësit përgjegjës janë të obliguar që ta ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e këtyre të dhënave. Për tu siguruar për këtë, këta punonjës janë të obliguar që ta nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit, me ç'rast e marrin përsipër mbajtjen sekrete të të dhënave konfidenciale gjatë dhe pas përfundimit të punësimit apo skadimit të kontratës me punëdhënësin. Deklarata për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë i bashkangjitet si shtojcë këtij udhëzimi administrativ.

Neni 8

Menaxhimi, mbledhja dhe ruajtja e video regjistrimeve

1. Video regjistrimet i nënshtrohen rregullave precize të ruajtjes, në mënyrë që të sigurojnë konfidencialitetin dhe autenticitetin e të dhënave.
2. Sistemi i vëzhgimit me kamerë do të regjistroj njëzet e katër (24) orë gjatë shtatë (7) ditëve të javës (24/7).
3. Video regjistrimet e bëra nga kamerat e sigurimit ruhen në DVR/NVR në afat të arsyeshëm prej tridhjetë (30) ditëve, përjashtimisht këtij afati, afati i ruajtjes mund të vazhdohet për aq kohë sa është e nevojshme, nëse pas kontrollimit konstatohet se incizimi përmban të dhëna për ndonjë veprë penale apo veprim tjetër të kundërligjshëm i cili e rrezikon rendin, sigurinë publike dhe objektin e gjykatës. Pas kalimit të këtij afati ato fshihen në mënyrë automatike nga sistemi.
4. Nëse gjatë apo pas regjistrimit, konstatohet keqpërdorimi, si humbja, shlyerja ose në një mënyrë tjetër tjetërsohet ose asgjësohet regjistrimi, ndaj personave përgjegjës do të iniciohet procedurë disiplinore apo penale.
5. Video regjistrimet që dokumentojnë ndonjë veprim të kundërligjshëm, dhe që mund të shërbejnë për qëllime të zhvillimit të hetimeve apo zhvillimit të procedurave gjyqësore ose disiplinore, ruhen nga administratori/ndihmës administratori i gjykatës si person përgjegjës, sipas rregullave për çështje të arkivimit të dokumenteve, bazuar në legjislacionin në fuqi.
6. Në rast se përmes video regjistrimeve dokumentohen veprime të kundërligjshme, menjëherë njoftohet administratori dhe kryetari dhe varësisht prej peshës së veprimit të kundërligjshëm edhe organet tjera përgjegjëse.
7. Sipas kërkesës dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit mund të kenë qasje në video incizimet. Zyrtarët nga organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit para fillimit të punës, ose para qasjes në sistemin për video mbikëqyrje, nënshkruajnë deklaratë për konfidencialitet dhe mbrojtje të të dhënave personale.
8. Çdo kërkesë për të pasur qasje në sistemin e vëzhgimit me kamerë dhe eventualisht për të marrë regjistrimet duhet të evidentohet në një libër të veçantë, në të cilët shënohen:
 - 8.1. emri, mbiemri dhe numëri personal i personit përgjegjës;
 - 8.2. data dhe koha e qasjes në sistem;
 - 8.3. qëllimi i qasjes në sistem;
 - 8.4. të dhënat e palës përfshirë emrin, mbiemrin, numëri personal dhe nënshkrimin e palës kërkuese;
 - 8.5. mediumi me të cilën merren të dhënat DVD, USB etj.

9. Të drejtën e qasjes me qëllim të kthimit të regjistrimeve, ruajtjes dhe transferimit tek palët e tjera e ka vetëm administratori i gjykatës përkatëse.

Neni 9

Kontrollimi i sistemit të kamerave të sigurimit

1. Administratori i gjykatës kryen kontrole periodike të sistemit të vëzhgimit me kamerë, në mënyrë që të sigurojë funksionim adekuat të sistemit elektronik të sigurimit.
2. Zyrtari përgjegjës i Sekretariatit të Këshillit siguron që secili punonjës i ri që pranohet në detyrë, qoftë administrator apo zyrtar i sigurimit, të vijoj trajnimin mbi punën me sistemin e kamerave dhe njoftimin me përgjegjësitë që dalin nga ky udhëzim.
3. Administratori i gjykatës, njofton menjëherë zyrtarin përgjegjës në Sekretariatit të Këshillit në rast të prishjes apo mosfunksionimit të sistemit të kamerave, i cili duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për evitimin e prishjes apo shkakut që bën sistemin e kamerave në gjykatë të jetë jofunksional.

Neni 10

Masat e sigurisë

1. Çdo sistem i vëzhgimit me kamerë dhe regjistrimet duhet të mbrohen duke aplikuar masat teknike dhe organizative të sigurisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar si:
 - 1.1. emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin;
 - 1.2. fjalëkalimi duhet të përbëhet nga së paku tetë (8) karaktere, duke përfshirë një shkronjë të madhe, numër dhe shenjë speciale;
 - 1.3. ndërrimi i fjalëkalimit të bëhet çdo tre (3) muaj;
 - 1.4. sistemi duhet të ruaj çdo gjurmë të qasjes në sistem (log file);
 - 1.5. instalimi i sistemit të vëzhgimit me kamerë duhet të jetë i qarkut të mbyllur dhe ndalohet transmetimi përmes internetit apo mjeteve të tjera të telekomunikimit.
2. Dhoma e monitorimit duhet të jetë e veçantë dhe qasje në të duhet të ketë vetëm personat e autorizuar.

Neni 11

Të drejtat e subjektit të dhënave personale të cilit i janë përpunuar përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë

1. Çdo subjekt, të dhënave personale të cilit i janë përpunuar përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë, sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka të drejtën e qasjes në të dhënave të tij.

2. Kërkesa për qasje në të dhënat e subjektit, të cilit i janë përpunuar të dhënat personale përmes sistemit të vëzhgimit të kamerave parashtrohet përmes kërkesës në formë të shkruar. Kërkesa për qasje në të dhënat personale i bashkangjitet si shtojcë këtij udhëzimi administrativ.

Neni 12 **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet Qarkorja Nr.2008/03 për Instalimin dhe Përdorimin e Kamerave të Sigurimit dhe Ruajtjen e Video Regjistrimeve në Gjyqësorin e Kosovës, dhe të gjitha dispozitat e tjera të akteve të miratuara në Këshill e që mund të bien në kundërshtim me këtë udhëzim administrativ.

Neni 13 **Shtojcat e rregullores**

1. Shtojcat që i janë bashkangjitur këtij udhëzimi administrativ, janë pjesë përbërëse e saj:
 - 1.1. Shtojca 1: Deklaratë për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë;
 - 1.2. Shtojca 2: Modeli i njoftimit/shenjës paralajmëruese;
 - 1.3. Shtojca 3: Kërkesë për qasje në të dhënat personale.

Neni 14 **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.



Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 31 . 07 . 2023

SHTOJCA 1

DEKLARATË

Për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Unë i/e poshtë nënshkruari/a,

.....(emri, mbiemri dhe nr i ID-së) në..... (vendi i punës), (sektori/departamenti), në pajtim me Udhëzimin për Instalimin dhe Përdorimin e Kamerave të Sigurimit dhe Ruajtjen e Video Regjistrimeve në Gjykatat e Republikës së Kosovës, marr përsipër se:

- do t'i zbatoj parimet për mbrojtjen e të dhënave personale në kryerjen e video mbikëqyrjes;
- do t'i zbatoj masat teknike dhe organizative për të siguruar besueshmërinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale dhe do t'i ruaj si të dhënat e besueshme personale, si dhe masat për mbrojtjen e tyre;
- do të bëj përpunimin e të dhënave personale në përputhje me udhëzimet e marra nga kontrolluesi;
- personave të tretë, me përjashtim të personave të autorizuar, nuk do tu jap asnjë të dhënë personale nga incizimet e video mbikëqyrjes, ose çfarëdo lloj të dhëne tjetër personale në të cilat kam qasje dhe të cilat i kam kuptuar, ose do t'i kuptoj gjatë mbikëqyrjes së sistemit të vëzhgimit me kamerë, përveç nëse në ligj nuk është parashikuar ndryshe;
- e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit si dhe pas përfundimit të tij si dhe marr përgjegjësinë e plotë që në qoftë se konstatohet që kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet të ndërmerren veprimet me legjislacionin në fuqi.

Më datë: ___ / ___ /20___

Nënshkrimi,.....

SHTOJCA 2

Modeli i njoftimit (shenjës paralajmëruese)

	HAPËSIRË E VËZHGUAR ME KAMERË! PROSTOR POD VIDEO NADZOROM! AREA UNDER VIDEO SURVEILLANCE!
	KONTROLLUESI: Kontrolor: <hr/>
	Kontakti: Kontakt: <hr/>
	INFORMATA LIDHUR ME PËRPUNIMIN: Informacijo e Obradi: Koha e ruajtjes: Vreme čuvanja: <hr/>
	Qëllimi i përpunimit: Svrha obrade: <hr/>

 MONITORIM	 POLICIA	 REGJISTRIM
---	---	--

 **AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI**
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY

Thirr pa pagesë në 0800 600 10
Pozovi besplatno na 0800 600 10
web: aip.rks-gov.net

SHTOJCA 3

Për: _____ në cilësinë
e kontrolluesit/përpunuesit.

Nga: _____, në cilësinë e subjekti të të dhënave
personale.

KËRKESË PËR QASJE NË TË DHËNAT PERSONALE

Në pajtim me nenin 14 të Ligjit Nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, kërkoj nga
_____ të jap qasje në të dhënat personale që ndërlidhen me mua, që janë
përpunuar përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Arsyet e kërkesës sime janë sepse:

Qasja në pamjet e vëzhgimit me kamerë më duhet për periudhën nga ora ___:___, deri në ora
___:___, datë ___/___/20___.

Ju lutem që regjistrimet më duhet t'i kem në _____ (USB, DVD etj).

Datë: _____. _____. _____

Parashtruesi i kërkesës*

Në: _____

(Nënshkrimi)

(emri dhe mbiemri)

* Parashtruesi i kërkesës mund të japë më shumë të dhëna nëse konsideron se janë të nevojshme.
Ndërsa nëse _____ ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e kërkuesit, ne mund të
kërkojmë paraqitjen e informacionit shtesë të nevojshëm për identifikim.